REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Broj 1132/20
Data/Datum 05-02-2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 1132/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi- Kryetar, z. Blerim Dina -Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "Vitech" SH.P.K -Prishtinë, kundër njoftimit për Anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje laboratorike në KRU Hidro Morava Gjilan dhe KRU Bifurkacioni Ferizaj", me numër të prokurimit: 020-7555-5-2-1, të iniciuar nga AK/. "CDI" ,më datën: 01.02.2021,mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Vitech" SH.P.K -Prishtinë, kundër njoftimit për Anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje laboratorike në KRU Hidro Morava Gjilan dhe KRU Bifurkacioni Ferizaj", me numër të prokurimit: 020-7555-5-2-1, të iniciuar nga AK/. "CDI".

II. VERTETOHET, njoftimi për anulim lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje laboratorike në KRU Hidro Morava Gjilan dhe KRU Bifurkacioni Ferizaj", me numër të prokurimit: 020-7555-5-2-1, të iniciuar nga AK/. "CDI",

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik: "Vitech" SH.P.K -Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik: "Vitech" SH.P.K –Prishtinë, që konform nenit 31 pika 4 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditës të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: "Vitech" SH.P.K -Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.12.2020 me nr. 1132/20, kundër njoftimit për Anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje laboratorike në KRU Hidro Morava Gjilan dhe KRU Bifurkacioni Ferizaj", me numër të prokurimit: 020-7555-5-2-1, të iniciuar nga AK/. "CDI", duke pretenduar se:

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 28 si dhe nenin 56, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.01.2021, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

OE ankues pretendon që Certifikatat e standardeve ndërkombëtare të kërkuara në kërkesën 3 tek kapacitetet teknike dhe ose profesionale,ne si OE konsiderojmë se është e pa drejtë dhe diskriminuese përfshirja e këtyre ISO-ve,jo relevante me natyrën e artikujve të kërkuara si dhe favorizon operator ekonomik të caktuar dhe një trajtim jo të barabartë. Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në platformën elektronike E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja ne sqarimet e dhëna për OE thotë se "Duke marr

parasysh qe OE ka kërkuar sqarime lidhje me ketë kërkese dhe pas analizës ton ne kemi ardhë ne përfundim se meqenëse ne ketë procedure te prokurimit nuk ka pune ndërtimore por vetëm furnizime me pajisje laboratorike, vetëm ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë qe është relevante me natyrën e këtij tenderi dhe do te mbete ne Dosjen e Tenderit dhe Njoftimi për Kontrate , ndërsa ISO-te tjera: Certifikatat ISO 14001 për Menaxhimi i Mjedisit; (iii) ISO 45001 për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune (bosht OHSAS 18001) qe janë jo relevante, edhe Do te largohen nga Dosja e tenderit dhe Njoftimi pe Kontrate" Andaj duke marrë parasysh sistemin e prokurimit që nuk lejon që Njoftimi për kontratë të ndryshohet me një njoftimi të ri për kontratë. Një gjë e tillë bëhet nëpërmjet korrigjimit,formularit B54,dhe këtë formular AK-ja e ka publikuar dhe janë hequr kërkesat për certifikatat tjera dhe është si në vijim: "Certifikatat dhe Standardet Ndërkombëtare - Operatorët Ekonomikë (konzorciumet në terren, aplikimi i ri) duhet të paraqesin një certifikatë që është në përputhje me (i)Certifikatat ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë. 3. Certifikata ISO 9001 certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organizatat kredibile ose nga trupat akreditues".

Një pretendim i tillë është i pa bazuar për faktin se sqarimet sipas dispozitave ligjore të LPP-së, të dhëna nga AK-ja në formularin standard B54 janë pjesë e Dosjes së tenderit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thotë se në dosjen e tenderit të pranuar me 21.12.2020 data e hapjes së tenderit është ndërruar për datën 31.12.2020 ora 14:00,ndërsa në platformën e e prokurimit data ka mbet e njëjtë sikurse më herët 23.12.2020,pra është kiju konfuzitet në lidhje me datën e hapjes së ofertave.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se në Njoftimin për Kontratë dhe në dosjen e tenderit data e hapjes së ofertave figuron data 23.12.2020,mirëpo në formularin B54 është zëvendësuar data 23.12.2020 dhe është vendosur data 31.12.2020 ora 14:00,andaj sqarimet ne formularin B54 janë bërë edhe pjesë e dosjes së tenderit ashtu siç parashihet në dispozita ligjore të LPP-së, e cila është korrigjuar dhe mban datën 31.12.2020 ora 14:00.

OE ankues thotë se për të njëjtat çështje kemi bërë edhe kërkesë për rishqyrtim por AK-ja nuk ka kthyer përgjigje. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja është dashur të veproj konformë dispozitave të nenit 108/A të LPP-së. Ndërsa sa i përket anulimit të aktivitetit të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se arsyeja e anulimit nuk është e mjaftueshme dhe nuk plotësohen kushtet ligjore konform nenit 62 të LPP-së për anulim të aktivitetit,andaj mendoj që AK-ja duhet të veproj konform dispozitave të Nenit 53.7 të LPP-së dhe të vazhdoj

me procedurat e prokurimit.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE: "Vitech" SH.P.K –Prishtinë të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që Autoriteti Kontraktues të vazhdoj me procedurat tjera të prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 18.01.2021 ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 18.01.2021, përmes emalit ka njoftuar OSHP-në. Të nderuar ju sqarojmë se ankesa me Nr. 1132/20 e dt. 18.01.2021 nuk është dashur të shqyrtohet fare sepse nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për shqyrtim, pasi që operatori ekonomik ankues nuk ka parashtruar fillimisht kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues-CDI. Pra në këtë rast nuk janë respektuar procedurat që parashihen sipas nenit 108/A të LPP-së, prandaj kjo ankesë është dashur te hedhet poshtë si e palejuar dhe të mos shqyrtohen pretendimet ankimore. Në këtë rast është dashur të analizohen në detaje se a janë plotësuar kushtet për shqyrtimin e kësaj ankese, e jo të shqyrtohen drejtpërdrejtë pretendimet ankimore pa u konsumuar shkalla e parë e shqyrtimit të kësaj ankese. Pra ne nuk pajtohem me ekspertizën dhe me konstatimet e ekspertit shqyrtues dhe kërkojmë nga paneli shqyrtues që të hedhet poshtë si e palejuar ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Operatori Ekonomik: datën 19.01.2021 përmes emalit ka njoftuar OSHP-në, Ju njoftojmë që pajtohemi pjesërisht me mendimin e Ekspertit Shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 01.02.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave,vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

OE ankues pretendon që Certifikatat e standardeve ndërkombëtare të kërkuara në kërkesën 3 tek kapacitetet teknike dhe ose profesionale, ne si OE konsiderojmë se është e pa drejtë dhe diskriminuese përfshirja e këtyre ISO-ve, jo relevante me natyrën e artikujve të kërkuara si dhe favorizon operator ekonomik të caktuar dhe një trajtim jo të barabartë. Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në platformën elektronike E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, Paneli Shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues sqaron se AK-ja ne sqarimet e dhëna për OE thotë se "Duke marr parasysh qe OE ka kërkuar sqarime lidhje me ketë kërkese dhe pas analizës ton ne kemi ardhë ne përfundim se meqenëse ne ketë procedure te prokurimit nuk ka pune ndërtimore por vetëm furnizime me pajisje laboratorike, vetëm ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë qe është relevante me natyrën e këtij tenderi dhe do te mbete ne Dosjen e Tenderit dhe Njoftimi për Kontrate , ndërsa ISO-te tjera: Certifikatat ISO 14001 për Menaxhimi i Mjedisit; (iii) ISO 45001 për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune (bosht OHSAS 18001) qe janë jo relevante, edhe Do te largohen nga Dosja e tenderit dhe Njoftimi për Kontrate" Andaj duke marrë parasysh sistemin e prokurimit që nuk lejon që Njoftimi për kontratë të ndryshohet me një njoftimi të ri për kontratë. Një gjë e tillë bëhet nëpërmjet korrigjimit,formularit B54,dhe këtë formular AK-ja e ka publikuar dhe janë hequr kërkesat për certifikatat tjera dhe është si në vijim: "Certifikatat dhe Standardet Ndërkombëtare - Operatorët Ekonomikë (konzorciumet në terren, aplikimi i ri) duhet të paraqesin një certifikatë që është në përputhje me (i) Certifikatat ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë. 3. Certifikata ISO 9001 certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organizatat kredibile ose nga trupat akreditues" Një pretendim i tillë është i pa bazuar për faktin se sqarimet sipas dispozitave ligjore të LPP-së, të dhëna nga AK-ja në formularin standard B54 janë pjesë e Dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues thotë se në dosjen e tenderit të pranuar me 21.12.2020 data e hapjes së tenderit është ndërruar për datën 31.12.2020 ora 14:00, ndërsa në platformën e e prokurimit data ka mbet e njëjtë sikurse më herët 23.12.2020, pra është kiju konfuzitet në lidhje me datën e hapjes së ofertave.

Lidhur me këtë pretendim ankimor Paneli Shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues sqaron se në Njoftimin për Kontratë dhe në dosjen e tenderit data e hapjes së ofertave figuron data 23.12.2020, mirëpo në formularin B54 është zëvendësuar data 23.12.2020 dhe është vendosur data 31.12.2020 ora 14:00,andaj sqarimet ne formularin B54 janë bërë edhe pjesë e dosjes së tenderit ashtu siç parashihet në dispozita

ligjore të LPP-së, e cila është korrigjuar dhe mban datën 31.12.2020 ora 14:00. OE ankues thotë se për të njëjtat çështje kemi bërë edhe kërkesë për rishqyrtim por AK-ja nuk ka kthyer përgjigje. Paneli Shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues sqaron se AK-ja është dashur të veproj konformë dispozitave të nenit 108/A të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Nuhi Paçarizi

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "CDI",

1x1 OE – "Vitech" SH.P.K -Prishtinë.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.